



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 9047, DATË 07.04.2003  
“PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës,

*Dekretoj*

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 9047,  
datë 07.04.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

**Nr. Dekretit 3803  
Tiranë, më 05.05.2003**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
ALFRED MOISIU**



60

**MOTIVIMI I KTHIMIT TË LIGJIT NR. 9047, DATE 07.04.2003  
“PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**Të nderuar deputetë,**

Më datë 15.04.2003, nga Kuvendi më ka ardhur për t’u dekretuar ligji nr. 9047, datë 07.04.2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të cilin vendosa të mos e shpall, por ta kthej edhe njëherë për shqyrtim në Kuvend.

Shkaqet që më shtyjnë për të bërë këtë janë si më poshtë:

1 – Neni 43 i ligjit të sipërcituar vjen në kundërshtim me nenin 166 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës, sipas parashkimeve në ligj. Kushtetuta në paragrafin e dytë të këtij neni, përcakton se shtetasit, të cilët për arsye ndërgjegje, nuk pranojnë të bëjnë shërbim në armë në Forcat e Armatosura, detyrohen që atë ta kryejnë në mënyrë alternative, sikurse parashikohet në ligj. Në kuptim të kësaj dispozite, shërbimi ushtarak është i detyrueshëm për të gjithë shtetasit e aftë dhe në moshën që përcakton ligji, sikurse me të drejtë është parashikuar në nenin 12 të ligjit të ardhur për dekretim. Për shtetasit e aftë të kryejnë shërbimin ushtarak Kushtetuta përcakton se ai është i detyrueshëm dhe vetëm për arsye të ndërgjegjes ajo mund të bëhet në mënyrë alternative, duke u konsideruar i kryer shërbimi ushtarak.

Përcaktimi, në nenin 43, se shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar ose përfundojnë shkollat e larta unviersitare me shkëputje nga puna, brenda dhe jashtë vendit, deri në 31 dhjetor 2005, nuk thirren për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ, e konsideroj se vjen në kundërshtim me nenin 166 të Kushtetutës, pasi sipas kësaj dispozite, megjithëse studentët nuk përfshihen në kategorinë e përcaktuar në nenin 12 të ligjit, ata, në kundërshtim me Kushtetutën, përjashtohen fare, nga kryerja e detyrimit të shërbimit ushtarak.

Pavarësisht, se neni 43 i ligjit, është dispozitë e përkohshme, përsëri mendoj se nuk është i justifikuar qoftë edhe për periudhë kalimtare shkelja e frymës së Kushtetutës.


2 – Neni 43 i ligjit vjen në kundërshtim dhe me nenin 18 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, të gjithë janë të barabartë para ligjit, askush nuk mund të

61

diskriminohet nëse nuk egziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Shmangia e kryerjes së shërbimit të forcave të armatosura, nuk gjykoj se përbën element të diskriminimit pozitiv, por, përkundrazi, ai krijon pabarazi përpara ligjit, për një shtresë të caktuar, e cila është pikërisht, grupi i shtetasve shqiptarë që mbarojnë shkollat universitare me shkëputje nga puna, deri në 31 dhjetor 2005.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
ALFRED MOISIU**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Alfred Moisiu', written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.